



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020
Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollit 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 1, të datës 25.03.2020, nga Kompania **Agani Ltd**, me seli në Prishtinë, me adresë: Graçanicë, me person përgjegjës **Kastriot Sefedini**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **Agani Ltd** me seli në Prishtinë, Graçanicë.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Glimepiride Denk 2, glimepiride, 2mg, 30 tableta: €1.28
2. Glimepiride Denk 3, glimepiride, 3mg, 30 tableta: €1.84
3. Metformin Denk, metformin, 1000mg, 30 tableta: €1.46
4. Metformin Denk, metformin, 850mg, 30 tableta: €1.30
5. Metformin Denk, metformin, 850mg, 120 tableta: €5.18
6. Metformin Denk, metformin, 500mg, 30 tableta: €0.88
7. Metformin Denk, metformin, 500mg, 100 tableta: €2.93
8. Panto Denk 20, pantoprazole, 20mg, 28 tableta: €2.27
9. Panto Denk 40, pantoprazole, 20mg, 28 tableta: €6.66

10. Desloral Denk 5, desloratadine, 5mg, 10 tableta :€1.64

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **Agani Ltd** me seli në Prishtinë, Graçanicë, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

- 1.Glimepiride Denk 2,glimepiride, 2mg, 30 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €3.56
- 2.Glimepiride Denk 3,glimepiride, 3mg, 30 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €4.77
- 3.Metformin Denk, metformin, 1000mg, 30 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €1.94
- 4.Metformin Denk, metformin, 850mg, 30 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €1.85
- 5.Metformin Denk, metformin, 850mg, 120 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €6.25
- 6.Metformin Denk, metformin, 500mg, 30 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €1.50
- 7.Metformin Denk, metformin, 500mg, 100 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €4.10
- 8.Panto Denk 20, pantoprazole, 20mg, 28 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €3.66
- 9.Panto Denk 40, pantoprazole, 20mg, 28 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €6.78
- 10.Desloral Denk 5, desloratadine, 5mg, 10 tableta për të cilin ka aplikuar për çmimin €1.64






Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/origjinës	Çmimi i final në Euro	Komenti nga komisioni
Glimepiride Denk 2	glimepiride	Tablet	2 mg	30 PCS	3.56		1.28	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Amaryl 2mg.
Glimepiride Denk 3	glimepiride	Tablet	3 mg	30 PCS	4.77		1.84	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Amaryl 3mg.
Metformin Denk	metformin	Film coated Tablet	1000 mg	30 PCS	1.94		1.46	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Glucophage 1000mg.
Metformin Denk	metformin	Film coated Tablet	850 mg	30 PCS	1.85		1.30	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Glucophage 850mg.
Metformin Denk	metformin	Film coated Tablet	850 mg	120 PCS	6.25		5.18	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Glucophage 850mg.
Metformin Denk	metformin	Film coated Tablet	500 mg	30 PCS	1.50		0.88	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Glucophage 500mg.
Metformin Denk	metformin	Film coated Tablet	500 mg	100 PCS	4.10		2.93	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Glucophage 500mg.
Panto Denk 20	pantoprazole	Gastro-resistant Tablet	20mg	28 PCS	3.66		2.27	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Controloc 20mg.
Panto Denk 40	pantoprazole	Gastro-resistant Tablet	40mg	28 PCS	6.78		6.66	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Controloc 40mg.
Deslora Denk 5	desloratadine	Film coated Tablet	5mg	10 PCS	1.64		1.64	Në mungesë të cmimeve në shtetet primare dhe sekondare cmimi është vendosur sipas cmimit në vendin e origjinës / cmimit të deklaruar nga bartësi i MAH

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar 
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare 
3. Etrit Tetova AKK anëtar _____
4. Amir Keka FSSH anëtar 
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar 
6. Dardan Nallbani MTI anëtar _____
7. Blerta Kika MF anëtare 

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.